



# Programi zviceran për bashkëpunim me Maqedoninë



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

State Secretariat for Economic Affairs SECO



## Angazhimi i Zvicrës për qytetarët e Maqedonisë

Zvicra i ka mbështetur proceset e tranzicionit politik, shoqëror dhe ekonomik në Maqedoni që nga viti 1992. Ky bashkëpunim bazohet në traditën e solidaritetit dhe përgjegjësisë së Zvicrës, gjithashtu e pasqyron edhe rëndësinë që Zvicra ia kushton stabilitetit dhe prosperitetit në Ballkanin Perëndimor. Sot, Zvicra renditet ndër partnerët më të mëdhenj të bashkëpunimit bilateral me Maqedoninë.

Qëllimet, temat dhe modalitetet aktuale të punës dhe angazhimit zviceran në Maqedoni, janë përcaktuar në një dokument të titulluar *Strategjia e Bashkëpunimit Zviceran në Maqedoni 2017-2020*. Kjo Strategji u hartua në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë në Maqedoni dhe u miratua nga Qeveria zvicerane. Detyrimi financiar për periudhën 2017 - 2020 është 76 milionë franga zvicerane.

Qëllimi i përgjithshëm i Bashkëpunimit të Zvicrës për periudhën 2017 - 2020 është të mbështesë Maqedoninë në reformat për të përmbushur standardet evropiane dhe për të ndërtuar një demokraci sociale dhe ekonomi të tregut, duke siguruar një qeverisje të shëndoshë të burimeve natyrore.

Ky synim është i lidhur ngushtë me prioritetet dhe politikat kombëtare të zhvillimit të Maqedonisë, me reformat e nevojshme për pranimin e Maqedonisë në BE, si dhe me Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

Programi Zviceran për bashkëpunim për periudhën prej vitit 2017 deri 2020, është i fokusuar në tre fusha prioritare:

- Qeverisje demokratike
- Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
- Infrastruktura dhe ambienti jetësor



## Qeverisja demokratike

Qeverisja demokratike dhe kultura e dialogut me qytetarët janë vendimtare për të ndërtuar një demokraci sociale në Maqedoni. Zvicra mbështet organet legjislative qendrore dhe lokale, me qëllim të praktikimit të proceseve politike të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ne, gjithashtu, inkurajojmë një shoqëri civile aktive dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrjen lokale dhe rajonale.

## Punësimi dhe zhvillimi ekonomik

Punësimi gjithëpërfshirës dhe rritja e qëndrueshme ekonomike janë kritike për krijimin e një shoqërie më progresive në Maqedoni. Zvicra i ndihmon punëkërkuessit të gjejnë punë dhe t'i fitojnë shkathtësitë e nevojshme. Ne, i mbështesim kompanitë startup dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) që të rriten dhe të krijojnë vende të reja pune. Puna jonë me institucionet kontribuon në sigurimin e një menaxhimi efektiv makroekonomik dhe fiskal.



## Infrastruktura dhe Mjedisi

Për të siguruar perspektivën afatgjatë të zhvillimit të Maqedonisë duhet të sigurohet ruajtja e kapitalit natyror - uji, toka, biodiversiteti. Zvicra i ndihmon komunitet të përdorin metoda prodhimi më të qëndrueshme. Mbështesim autoritetet qendrore dhe lokale në integrimin e mjedisit në planet e tyre zhvillimore. Investojmë në furnizimin me ujë, në infrastrukturë për ujërat e zeza dhe mbetjeve të ngurta dhe mbështesim ndërmarrjet komunale në ofrimin e shërbimeve më të mira publike.





## Modalitetet e punës

Puna e Zvicrës bazohet në marrëveshje formale me autoritetet maqedonase dhe zbatohet me bashkëfinancim kudo që të jetë e mundur. Organizatat e shoqërisë civile janë partnerë të rëndësishëm për Zvicrën, pasi ato i përfaqësojnë nevojat dhe aspiratat e qytetarëve. Gjithashtu, kultivohen partneritetet me sektorin privat si vektorë për zhvillim dhe inovacion, veçanërisht në fushën e zhvillimit ekonomik.

Mbështetja jonë sigurohet kryesisht përmes projekteve që realizohen nga zbatuesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Në programimin dhe në operacionet tona, vëmendje e veçantë i kushtohet temave transversale: barazisë gjinore, qeverisjes së mirë, përfshirjes sociale dhe ndjeshmërisë ndaj konflikteve.





## **Kontakt**

Ambasada e Zvicrës në Republikën e Maqedonisë  
Maksim Gorki 19, 1000 Shkup, Maqedoni  
[www.eda.admin.ch/macedonia](http://www.eda.admin.ch/macedonia)  
E-mail: [skopje@eda.admin.ch](mailto:skopje@eda.admin.ch)  
Tel: +389 2 310 33 40

*Strategjinë e Bashkëpunimit Zviceran në Maqedoni 2017-2020* mund ta gjeni në:  
[www.eda.admin.ch/countries/macedonia/en/home/international-cooperation/publications-multimedia.html](http://www.eda.admin.ch/countries/macedonia/en/home/international-cooperation/publications-multimedia.html)